



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:264479
Datë: 21.10.2021
Numri i dokumentit: 02308322

A.nr.1023/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me zyrtaren ligjore Besë Sylaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditëses, Z...G..., nga fshati V..., -k, komuna Pejë, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me numër 03-12/10961, të datës 15.03.2019, në shqyrtimin kryesor publik, në prani të palës paditëse, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 18.10.2021. merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses, Z...G..., nga fshati V..., komuna Pejë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë, MPMS/DFDIL-së, me numër 03-12/10961, i datës 15.03.2019, dhe çështja kthehet në rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Seanca e shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të palës paditëse, dhe në mungesë të palës së paditur, e ftuar në mënyrë të rregullt (Provë: fletë-kthesa e datës 30.09.2021).

Paditësja në padinë e saj, të parashtruar në këtë gjykatë me datën 30.04.2019, thekson se, me vendimet e organeve të administratës i është refuzuar kërkesa, respektivisht ankesa, për njohjen e statusit të Familja e Veteranit pas Vdekjes. Vendimet e kontestuar kanë ardhur si rezultat i zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit material, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe me shkelje të dispozitave procedural. Kjo për faktin se ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit për invalidët e luftës, familjeve të dëshmorëve dhe viktimave civile, ligjit nr.04/L-261, dhe ligjit nr.04/L-172, nuk kanë marrë parasysh provat e paraqitura nga paditësja, e paditura nuk ka vlerësuar lidhjen familjare mes paditëses dhe ish bashkëshortit, dhe vendimi përmban shkelje të dispozitave të LPPA-së në arsyetimin e tij. Edhe pas shkurorëzimit në vitin 2006, të njëjtët kanë vazhduar të jetojnë në të njëjtën bashkësi, ku janë kryer marrëdhëniet normale familjare, dhe ku e njëjta ka

vazhduar të mbajë mbiemrin e ish-bashkëshortit. Nga të shënuarat, paditësi i propozon gjykatës që të nxjerrë aktgjykim me të cilin, aprovohet kërkesë padia, dhe anulohen vendimi 03-12/10961, i datës 15.03.2019, i të paditurës, dhe çështja t'i kthehet të paditurës në rivendosje.

Paditësja në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare, deklaroi: "kërkoj nga gjykata që të aprovohet kërkesë padia ime si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës me nr. 03-12/10961, i datës 15.03.2019, dhe çështja të kthehet tek e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje. E njoftoj gjykatën se arsyeja pse më është refuzuar kjo e drejtë është se kam bërë shkurorëzimin në vitin 2006, mirëpo, ne kemi jetuar gjithmonë së bashku".

E paditura me përgjigjen në padi të parashtruar në gjykatë me datën 08.04.2021, e ka kontestuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit, duke theksuar se vendimi i atakuar është marrë konform të dispozitave ligjore në fuqi dhe i bazuar në dokumentacionin e lëndës dhe konstatimeve të komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë, i ka refuzuar ankesën si të pabazuar, duke theksuar se nuk i plotësor kriteret e parapara në Ligjin nr.04/L-054. Ndërsa paditësi pretendimet e veta nuk i ka dokumentuar me asnjë provë, andaj, i propozon gjykatës që të nxjerrë aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit Z...M... G..., nga fshati V..., komuna Pejë të pa bazuar, duke vërtetuar vendimin e të paditurës numër 03-12/10961, të datës 15.03.2019.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor – publik të datës 18.10.2021, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i datës 15.03.2021; aktgjykimi me numër C.nr.373/06, i datës 15.12.2009; ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile për Z...G...i datës 24.04.2019; kopja e letërnjoftimit për Z... G..., të datës 07.02.2011; deklarata e datës 22.10.2018, e vërtetuar te noteri me numër 3488/2018; deklarata nën betim, me numër 6251/2018; rishqyrtimi i datës 30.10.2018; deklarata e bashkësisë familjare, datës 24.06.2018, me numër 17-17-007-3; ekstrakti nga regjistri qendror për E... G...e datës 28.06.2018; certifikata e lindjes për Erëza Gashi, e lëshuar më datë 28.06.2018; certifikata e lindjes për E... G...e datës 28.06.2018; certifikata e vdekjes për B...G...e datës 27.06.2018; certifikata e veteranit të UÇK-së për B... G...e datës 26.04.2018; vërtetimi tatimor i datës 11.07.2018; vërtetimi nga arkivi për Z... G...i datës 30.10.2018; propozimi i datës 23.10.2018, pranë Gjykatës Themelore në Pejë; ankesa e datës 30.10.2018, me numër 368/18; vërtetimi i datës 10.07.2018, me numër 44615/2018; vendimi i datës 01.11.2017; formulari për aplikim, i datës 11.07.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, dhe pas dëgjimit të pretendimeve të palëve në procedurë, dhe pas vlerësimit të provave të administruara, konstatoi se padia e paditësit është e pa bazuar.

Me vendimin e të paditurës -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile MPMS-DFDIL-së, si shkallë e dytë, me numër dosje 03-12/10961, të datës 15.03.2019, refuzohet ankesa e tani paditëses.

I pakënaqur me këtë vendim, paditësja më datë 30.04.2019, paraqet padi në këtë gjykatë, duke kontestuar ligjshmërinë e tij.

Për të vlerësuar këtë çështje juridike, gjykata fillimisht i'u referua nenit 20 të Ligjit nr. 04/l -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili përcakton se, Pas vdekjes së veteranit, të drejtën e pensionit të trashëgimtarit e përfitojnë vetëm bashkëshorti/ja e papunësuar, fëmijët e miturit dhe prindërit e veteranit, në rastin kur nuk përfitojnë pensione nga sigurimet shoqërore. 2. Fëmijët e veteranit, të cilët janë nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare në kohën e vdekjes së tij kanë të drejtë që pas vdekjes së pensionistit të marrin pensionin e fëmijëve trashëgimtarë. 3. Moshë e rregulluar në paragrafin 2. të këtij neni ngritët në njëzetegjashtë (26) në rastet kur fëmijët vijojnë shkollimin e rregullt, brenda kohëzgjatjes së periudhës së shkollimit të rregulluar me ligj. 4. Fëmijët me aftësi të kufizuara të veteranit kanë të drejtë të marrin pensionin e fëmijëve trashëgimtarë pavarësisht nga mosha, nëse ata janë me aftësi të kufizuara në datën e vdekjes së pensionistit, sipas kushteve të njëjta të përcaktuara për pensionin e zakonshëm publik, nëse është përcaktuar dhe në atë masë sa përcaktohet sipas ligjit në fuqi. 5. Përparësitë në realizimin e të drejtave, në mes të anëtarëve të familjes së ngushtë sipas këtij ligji, përfituesit i realizojnë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë. Anëtarët e familjes të radhës së njëjtë të trashëgimisë, do t'i realizojnë të drejtat sipas marrëveshjes së ndërsjellët. Në qoftë se marrëveshja nuk arrihet, përparësi në realizimin e të drejtës ka anëtarë i familjes së ngushtë nga radhët e njëjtë trashëgimore, i cili me personin nga i cili realizohet e drejta, ka jetuar në bashkësi të njëjtë familjare.

Me tutje, nenit 3 pika 1.12 dhe 1.12.1 i te njëjtit ligj përcakton se, Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të këtij ligji janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtra si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesore; 1.12.1. statusi i bashkësisë jashtëmartesore sipas këtij ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtë kontestimore.

Gjykata nga administrimi i provave respektivisht nga shkresat e lëndës ka vërejtur se, me datën 20.12.2017, është miratuar kërkesa B... (F..) G... me numër te dosjes 03-05-10091 për njohjen e të drejtës në pensionin personal të veteranit –luftëtar të UÇK-së i cila kjo e drejtë ju është njohur prej datës 01.11.2017, në shumën mujore 170 euro deri me datën 17.02.20218, ku ndërprerja e kësaj të drejte është bërë sipas certifikatës së vdekjes me numër 17/20018rv/17001, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Pejë - i ndjeri B... G..., kishte vdekur me datën 17.02.2018.

Nga kjo, paditësja Z... G..., ka kërkuar nga e paditura që ti njihet e drejta për Pensionin të Skemës- Familja e Veteranit të Luftës, ku me të cilën ju është refuzuar ankesa me arsyetimin se, paditësja është e

shkurorëzuar nga i ndjeri B... G... (i cili këtë të drejtë e ka realizuar nga data 01.11.2017, deri me datën 17.12.2018), andaj, edhe nuk mund të gëzojë këtë të drejtë bazuar në dispozitat e Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, Ligjit Nr.04/L-172 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-056, Ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Procedurat e Aplikimit në Skemën e Pensioneve dhe Beneficioneve të përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-054 në Ligjin Nr.04/L-172 dhe në Ligjin Nr.04/L-261 të MPMS-së”.

Ndërlidhur me këtë, gjykata ka vërejtur se, paditësja, Z... G..., ishte e shkurorëzuar nga i ndjeri B... G...- me Aktgjykimin me numër C.nr. 373/06 i datës 15.12.2006, andaj, sipas dispozitave të lartcekura e paditura drejtë ka vendosur lidhur me ankesën e paditëses se, nuk mund të realizon të drejtën e pensionit të skemës-familja e Veteranit të luftës. Për me tej, të drejtën e pensionit lartcekur në rastin konkret mund të ju takoj anëtarëve të familjes së ngushtë -fëmijëve të ndjerit B... G..., nëse plotësohen kushtet në kuptim të nenit 20 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/l -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Procedurat e Aplikimit në Skemën e Pensioneve dhe Beneficioneve të përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-054 në Ligjin Nr.04/L-172 dhe në Ligjin Nr.04/L-261 të MPMS-së”.

Nga të lartcekurat, Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues ka konstatuar se, organi administrativ, pasi ka vlerësuar pretendimet ankimore me rastin e refuzimit të ankesës së Zjavora Gashi drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur paditëses ia ka refuzuar ankesën si të pa bazuar në kuptim të dispozitave të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, Ligjit Nr.04/L-172 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-056, Ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Procedurat e Aplikimit në Skemën e Pensioneve dhe Beneficioneve të përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-054 në Ligjin Nr.04/L-172 dhe në Ligjin Nr.04/L-261 të MPMS-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditëses të dhëna në padi, por të njëjtat pretendime i refuzoi si të pa bazuara, nga arsyeja se paditësja të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat kishin me ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetojë një tjetër të gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur. Prandaj, nga të lartcekurat, gjykata në këtë çështje administrative vendimin e të paditurës e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm, nuk ka të meta për shkak të cilave mund të anulohet, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditëses. Mbi këto arsye, gjykata kërkesëpadinë e paditëses nuk e aprovoi, sepse vlerësoi se, nuk është zbatuar ligji në dëm të njëjtës.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1023/19- datës 18.10.2021

Zyrtare Ligjore
Besë Sylaj

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.